



Historia e hershme dhe etimologjia

Rrethina e Prishtinës, si hapësirë në pjesën qendrore të gadishullit ballkanik ka gjurmë të banimit qysh nga koha e neolitit. Në afërsi të Prishtinës ndodhet edhe qyteti antik i Ulpianës, i cili është themeluar në shekullin I dhe ka qenë i banuar deri në shekullin 7-të. Që nga viti 518 ka filluar të braktiset pas një temleti shkatërrues. Në afërsi të Prishtinës ndodhet edhe vendbanimi i Graçanicës, ku ndodhet kisha ortodokse e themeluar në vitin 1321 në rrënojat e një kishë të shekullit VI. Në themelet e kësaj kishë mund të shihen edhe pllaka të mermerit me mbishkrime latine. Nuk dihet etimologjia e emrit Prishtinë, megjithëse shumë hipoteza janë propozuar.

Shekulli 14 deri 19

Dokumenti i parë historik i cili e përmendi Prishtinën sipas emrit, daton nga viti 1342 kur, Pe-randoria Bizantin Jan VI Kantakouzenos përshkruan Prishtinën si një "fshat i rrethuar pa mure". Prishtina bie nën pushtimin osman qysh nga beteja e Kosovës (1389). Kjo betejë shënon fundin e sundimit serb në Kosovë, dhe në përgjithësi shënon rënien e periudhës bizantine. Të dhënat e para që dalin në vitin 1477, në Deftërin osman, e përshkruajnë Prishtinën si vendbanim me 9 lagje dhe 351 shtëpi. Periudha osmane njih zhvillimin e qytetit përmes ndërtimeve të ndryshme kryesisht fetare por edhe publike. Në këtë periudhë janë ndërtuar hamame, xhami, çeshme, rrugë, hane dhe paze.

Duke shërbyer edhe si qendër e tregëtisë, në Prishtinë për një periudhë gjatë shekullit 17 dhe 19 është mbajtur edhe panairi ndërkombëtar i mallërave, ku tregtarë nga vende të ndryshme të botës kanë qenë vizitorë dhe tregëtar. Ndërkohë në shekullin 19 në shtëpinë e Emin Gjikut hapet edhe muzeu i parë, ku ekspozohen ekspozate private të familjes.

Prej vitit 1883 deri në vitin 1897, Prishtina bëhet kryeqyteti i Vilajetit të Kosovës. Në këtë kohë, ashtu si në të gjithë perandoritë vërehen edhe ndikimet e para të arkitekturës evropiane. Prishtina në vitin 1874 kishte ndërtuar edhe stacionin e parë të trenit, ndërtesë e ndërtuar nga britanikët.

Shekulli 20

Në vitin 1912 Prishtina çlirohet nga pushtimi osman përmes forcave të udhëhequra nga Ha-



Xhamia e Gurit

Në Prishtinë, Themelet e saj janë vendosur në vitin 1392, vetëm tre vjet pas betejës së Kosovës. Xhaminë e ka nisur Sulltan Bajaziti, ndërsa e ka përfunduar Sulltan Fatihu. Karakteristikë e saj është minaria tërësisht nga guri.

san Prishtina. Në po të njëjtin vit, ajo pushtohet nga forcat serbe. Në vitin 1915 ajo shkurtimeisht vendoset edhe nën sundimin bullgar, deri në vitin 1918 kur forcat franceze e kthejnë në okupim të Moretës Jugosllave. Kjo periudhë përçjelllet me program intensiv të kolonizimi serb, që përcillet edhe me tjetërsim të pronave nga popullata shqiptare. Kjo si rezultat sjellë dyndje të shqiptarëve nga Prishtina, duke e krijuar një mërgatë shqiptare në Turqi që vazhdon ende të jetë aty.

Në vitin 1941 Italia e përfshin Prishtinën si pjesë të okupimeve në kuadër të fushatës së saj ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore (LDB).

Xhamia e Sulltanit **10** Është ndërtuar sipas urdhrit të Sulltan Mehmet Fatihut II -Pushtuesit. Sipas mbishkrimit në gjuhën arabe që ndodhet mbi portalin e hyrjes, xhamia është ndërtuar në vitin 1461. Gjatë luftërave austro-turke në fund të shekullit XVII, kjo xhami është shndërruar në kishë katolike. Këtu ka qenë i varrosur Pjetër Bogdani, njëri ndër shkrimtarët më të hershëm shqiptarë. Pas humbjes së luftës së austriake në vitin 1690 eshtat e Bogdanit zhvarrosen dhe hidhen në rrugë nga ushtria turke dhe ndërtesës i kthehet funksioni i mëparshëm.

Gjatë kësaj periudhe Prishtina bëhet pjesë e Shqipërisë së pushtuar nga Italia. E më pas, për një kohë të shkurtër deri në çlirim edhe nga Gjermania. Pas LDB Kosova bëhet provincë autonome e Republikës Socialiste të Jugosllavisë.

Prishtina u shpall kryeqyteti i Kosovës më 1947. Në vitin 1953 zhvillohet plani urban për një qytet "modern" prej 50.000 banorësh, mbiqërmadhat e qytetit të vjetër. Gjatë viteve të 1950-a deri në vitet e 1970-a, nën moton "shkatërro të vjetrën dhe ndërto të renë" u rrënuan pjesë të lagjeve të qytetit, për tu ndërtuar ndërtesa banimi, administrative, shëndetësore, shkollore, sheshe, e përmendore. Fragmente të lagjeve të dikurshme sot kemi në zonën që njihet si Qendra Historike e Prishtinës, ku është SahatKulla, Xhamia e Gurit, Xhamia e Mbretit etj. Më 1988 Prishtinës iu mbuluan dhe betonuan lumenjtë Prishtevka dhe Vellusha.

Kushtetuta e Kosovës

Në vitin 1974 statusi i Kosovës ndryshon përmes aproimit të Kushtetutës së Kosovës që do t'i jepte vendit statusin e de facto republikës brenda Jugosllavisë, megjithëse de jure ende konsiderohej rajoni i Serbisë. Kosova kishte të gjitha të drejtat që i kishin republikat tjera, në përjashtim të shkëputjes. Me këtë Kushtetutë, hapet Universiteti i Prishtinës në gjuhën shqipe, kurse edhe punësimi i shqiptarëve si shumicë përmirësohet ndjeshëm, duke krijuar rrethana të reja në Prishtinë dhe Kosovë. Periudha njihet edhe për investimet e mëdha në kryeqytet, ku lagjet si Bregu i Diellit, Dardania, Ulpiana janë ndërtuar. Ndërsa edhe ndërtesat si Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Rilindja dhe Pallati i Rinisë me emrin Boro dhe Ramizi poashtu janë ndërtuar në këtë kohë. Kjo periudhë e lulëzimit zgjatë deri në vitin 1989 kur shpërbërja e Jugosllavisë përçjelllet me masa të reja për statusin e Kosovës.



gram të cilin shqiptarët në Kosovë po e ndiqnin përmes antenave satelitare.

Të gjitha ndërtesat e institucioneve të Kosovës, përfshirë kuvendin, qeverinë, shkollat, bankat, universitetin, spitalet dhe fushat sportive u vendosën në administrim ekskluzivisht të serbëve. Shqiptarët u përjashtuar nga të gjitha vendet e punës. Përveç sagregimit, kjo dekadë njih edhe rritjen e dhunës fizike dhe dëbimin e popullatës nga Kosova. Vetëm gjatë tremujorit mars-qershor 1999 rreth një milion shqiptarë janë dëbuar shtetet e rajonit dhe Evropës.

Pas gati një dekadë rezistence paqësore përmes sistemit paralel, në vitin 1998 filloi edhe lufta gushtër me shqiptarëve të organizuar përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ushtrisë dhe forcave paramilitare të Serbisë. Për shkak të dhunës ndaj civilëve shqiptar dhe dëbimit masiv që përdodhete, forcat e NATO's me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare intervenuan me sulme ajrore, duke e detyruar shtetin Serb të lëtiqhet nga Kosova. Me nënshkrimin e Mar-rëveshjes së Kumanovës më 9 qershor vendoset stabiliteti në Kosovë. Forcat serbe u tërhoqën nga Kosova dhe populli i Kosovës u kthye nëpër shtëpitë e veta.

Shekulli 21

Pas çlirimit Prishtina bëhet kryeqytet i Kosovës si pretorinat ndërkombëtar që udhëhiqet nga një ministri i Kombeve të Bashkuara me emrin



United Nations Mission in Kosovo (UNMIK). Protektorati zgjatë deri në vitin 2008 kur Kosova shpallë pavarësinë. Ajo menjëherë pranohet nga SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia duke nisur kështu rrugëtimin e vendit si shtet i pavarur. Që nga 1999 Prishtina ka një ndryshime të mëdha në infrastrukturë dhe organizim. Për shkak të kërkesës në rritje për dyndje urbane, janë krijuar lagje të reja, ndërkohe që shumë lagje të vjetra të banuara me shtëpi janë riorganizuar në lagje me banesa shumëkatëshe.

Prishtina sot është në proces të planifikimit, riorganizimit, dhe ribulimit në nivel institucional. Me përpjekje për të konservuar ndërtesa të trashëgimisë kulturore që janë gjurmë të historisë së pasur të qytetit. Dhe me projekte të reja ambicioze për lagje moderne, ndërtesa institucionale, parqe, ndërtesa kulturore, rekreative e sportive dhe me hapësira publike. Prishtina është në rrugën e saj për tu kthyer në një kryeqytet të denjë të Evropës.

 Policia 038/192 në telefon mobil 192,112	 NUMRA ME RËNDËSI	Aeroporti Adem Jashari 00383(0)385015021214 Stacionet e policisë nga 038 Nr.1: 00383(0)504-604-5059 Nr.2: 00383(0)504-604-6748 Nr.3: 00383(0)504-604-6796 Nr.4: 00383(0)504-604-2997
Ambulanca 194		Stacioni i autobusëve +381 38 550 011 +381 38 541 517 +381 38 540 142
Zjarrfikësat 193		
Qendra Klinike Universitare e Kosovës 00383(0) 500-600		
Emergjencia 00383(0) 500 094.		

HYJNESHA NË FRON

Është simbol i qytetit që nga viti 1999. Figura nga terakota është gjetur në afërsi të Prishtinës dhe besohet se është rreth 6.000 vjet e vjetër.

Pallati i Rinisë dhe Sporteve

16 U ndërtua në vitin 1977 dhe ka një hapësirë rreth 10.000 metra katrorë. Pallati është një stadium me 2 fusha sportive, dy qendra të kongresit, një librari, qendër tregtare dhe parking të brendshëm e të jashtëm. U emërua "Boro dhe Ramizi" për nder të dy partizanëve dhe herojnë të Jugosllavisë, serbit Boro Vukmiroviq dhe shqiptarit Ramiz Sadikut, për të promovuar idenë propagandistike të Vilaznim-Bashkimit të ish-RSFI-së. Në vitin 2000, një pjesë e ndërtesës, përfshirë sallën sportive, është djegur dhe ka mbetur e parregulluar që nga atëherë.

Hotel "Grand"

18 Është zemra e Prishtinës dhe është projektuar nga Bashkim Fehmiu dhe Dragan Kovaceviq. Grand Hotel është një nga monumentet kryesore të Prishtinës dhe është një përfaqësues i madh i arkitekturës së viteve 80-të në Kosovë. Planet fillestare për hotelin parashikojnë se terraca e pasme do të ishte e lidhur me një urë për Pallatin e Rinisë dhe Sporteve. Në katin më të lartë gjendet "dhoma e Titos" ku udhëheqësi jugosllav ka fjetur dikur.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës

17 E ndërtuar në vitin 1974 dhe e dizajnuar nga arkitekti kroat Andrija Mutnjakoviq, ndërtesa e bibliotekës si tërësi arkitekturore paraqet një kombinim të kubeve dhe të kupolave, ndërsa i përket tipit të arkitekturës të "regjionalizmit të ri". Gjithsej janë 79 kupola të ndara me segmente që i përgjajnë trurit dhe simbolikisht e paraqesin dijen. Ndërtesa është katërkateshe me sipërfaqe prej 16.500 m², prej të cilave 13.500 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme. Biblioteka ka sala të leximit, sallën e periodikut, hapësirat për laboratorë e konservimit të librit, foto-laboratorin, libër-lidhëtorën, depotë, hapësirat administrative dhe 2 amfiteatra. Që nga viti 1982, Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës, e njohur në atë kohë si Biblioteka Popullore dhe Universitare e Kosovës, e fillon veprimtarinë e vet në këtë ndërtesë.



Ky publikim është përpiluar me qëllim të përmbledhjes së informatave kryesore që lidhen me historinë e qytetit të Prishtinës. Materialet janë mbledhur nga një ekip punues i emëruar nga Komuna e Prishtinës në vitin 2018 dhe janë organizuar kronologjikisht. Një pjesë e të dhënave më karakteristike janë veçuar si dormca të informatave në fund. Narrativa është bazë për përdorim në materialet informuese të Komunsë së Prishtinës, në fushat e turizmit, kulturës dhe të tjera. Fotografitë në këtë publikim janë me të drejta të hapura dhe mund të përdoren dhe replikohen nga çdokush. Të gjitha materialet e këtij dokumenti janë të hapura për të gjithë për kopjim, ripërdorim dhe publikim.



Komuna e Prishtinës
Rruga UÇK pn
prishtinaonline.com

Shtatoria "Bill Clinton"

10 Në vitin 2009, është punuar statuja e ish-presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton, nga skulptori Izet Mustafa. Statuja u punua për ta nderuar presidentin për ndihmën dhe rolin e tij gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë. Gjatësia e skulpturës është rreth 3 metra dhe në dorën e majtë presidenti e mban mirënjohjen "Honoris Causa" që i është dhënë nga Universiteti i Prishtinës. Statuja është e vendosur në sheshin e emëruar sipas presidentit Bill Clinton.




Përmendorja e Lirisë

12 U dizajnu nga skulptori serb Miodrag Žir-koviq në vitin 1957 dhe u ndërtua në vitin 1959. Përmendorja Vilaznim-Bashkim u ndërtua gjatë një kohe kur po ndodhnin ndryshime të mëdha në kryeqytetin e Kosovës. Autoritetet jugosllave sollën një frymë të re të realizmit socialist, i cili u manifestua edhe nëpërmjet arkitekturës. Si pas autorit, përmendorja simbolizon bashkimin e etnive të ndryshme që jetonin atëkohë në Prishtinë.



Strehimorja e Arinjeve

11 Sanctuary Bear Prishtina është një park kombëtar në Kosovë që gjendet në afërsi të qytetit të Prishtinës. Për shumë vite, nuk kishte ligj kundër mbajtjes së ariut të kafshë në Kosovë. Të gjithë arinjtë e mbajtur privatisht kanë jetuar në kafaze të vogla nëpër restorante. Ata kanë lindur kryesisht në pyjet e Kosovës ose të Shqipërisë dhe janë rrembyer prej nënave të tyre nga tregtarët e kafshëve. Si arinjtë të restoranteve ata duhet të tërhoqin klientë dhe kështu përfitonin pronarët e tyre. Në nëntor të vitit 2010, kur u bë e paligjshme për të mbajtur arinjtë privatisht, u shfaq nevojja për një park kombëtar si një shtëpi e re për arinjtë e shpëtuar nga robëria. Sanctuary Bear Prishtina u themelua në vitin 2013 nga Four Paws Austria në bashkëpunim me KFOR-in, Qytetin e Prishtinës, Ministrinë e Mjedisit të Kosovës, dhe firmën ligjore Franke & Partner. Sanctuary ofron strehim të përshtatshme për të gjithë arinjtë e restoranteve, me rrethime të mëdha që i përgjajnë habitatit natyror të arinjeve.



Ulpiana arkeologjike

15 Ulpiana, ndryshe Municipium Ulpiana dhe Justiniana Secunda, ishte një qytet romak në rrethin e Graçanicës qysh nga fundi i shekullit II, që zhvillimin më të madh e ka arritur në periudhën në mes të shekujve III dhe IV. Gjatë kësaj periudhe kohore, qyteti e kishte epitetin Municipium Ulpiana Splendissima - Municipi i Ulpianës Madhështore apo të Shkëlqyer, duke u karakterizuar me rrjetë të rrugëve të drejta, sistem ortogonal, ujësjellës, objekte të banimit si dhe me objekte publike, sakrale, profane e utilitare, posaçërisht gjatë sundimit të perandorit Justinian në shekullin VI, kohë kjo kur riemërohet në Justiniana Secunda.

Gjatë periudhës romake, gjeografikisht, Ulpiana ishte njëra nga qendrat kryesore gravituese komunikuese në mes të Konstantinopolit dhe Romës, për shkak të pozicionit afër kryeqëzimit të rrugëve që e lidhinin Detin Adriatik me Detin Ege dhe jodrejtpërdrejët me Detin e Zi, gjithashtu edhe falë pozicionit afër kryeqëzimit të rrugëve Via Lissus-Naissus dhe atë të Scupit.



Monumenti Newborn

13 Është skulptura tipografike që ka shënuar ditën e Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008, ditë edhe në të cilën është vendosur para Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Monumenti u punua pa ndalur për 10 ditë me rend në mënyrë që të përfundohet për datë të pavarësisë. Fillimisht ngjyra e shkronjave ishte e verdhë, mirëpo tradicionalisht ngjyrat e shkronjave ndryshojnë çdo 17 shkurt. Dimensionet e monumentit janë 3 metra lartësi, 24 metra gjatësi, dhe 0,9 metra trashësi, kurse pesha e saj është rreth 9 tonelata.



Muzeu i Kosovës

14 Ndërtesa monumentale eklektike "Muzeu i Kosovës" gjendet në zonën historike të qytetit të Prishtinës. Ndërtesa është ngritur më 1885/86 sipas projektit të punuar në Zyren Ushtarake në Graz, si ndërtesë për stafin e garnizonit osman. Deri në vitin 1975 ndërtesa është përdorur si seli e komandës ushtarake gjatë regjimit të ish-RS-FJ për rajonin e Prishtinës. Prej vitit 1980, kjo ndërtesë shfrytëzohet si Muze i Kosovës. Planimetria e ndërtesës është drejtkëndëshe e ndërtuar me materiale ndërtimore si gurë, tulla, dru e mermer. Kulmi është rindërtuar dhe i takon tipit "mansard" i mbuluar me tregulla "moderne". Pjesa frontale e ndërtesës theksohet me një ritëm të njëtrajshëm të hapjeve dhe shkallëve të theksuara simetrike njëkrahëshe, me planime-tri gjysmëharkore që çojnë nga përdhësa deri në kat të parë. Muzeu i Kosovës si institucion është themeluar në vitin 1949.

Qendra Historike

1 2 3 4 5 6 7 8 9 Qendra Historike e Prishtinës apo Zona Historike e Prishtinës përfshin një numër të madh objektesh të trashëgimisë kulturore dhe që gjenden në pjesën më të vjetër të qytetit të Prishtinës që dikur e kishte rolin e bërthamës së qytetit. Në këtë pjesë janë zhvilluar të gjitha aktivitetet e jetës shoqërore, administrative, ekonomike, zejtare, politike. Kulturore dhe edukative. Çarshia e qytetit, hamami, hanet, dyqanet, xhamitë, shtëpitë individuale dhe sahatkulla ishin elementet që e përbënin bërthamën e Prishtinës së vjetër. Sot kjo pjesë është e mbrojtur si Qendra apo Zona Historike e Prishtinës.

Prishtina i ka 15 linjat të transportit publik që lidhin fshatrat dhe lagjet me qendrën e qytetit.



Baret dhe kafeteritë - Pjesë shumë e madhe e mënyrës së jetesës në Prishtinë janë baret dhe kafeteritë. Rrugë të tëra janë të dedikuara dhe të stërmbluara me bare dhe kafeteri. Kafetë e rakisë dhe kafetë e vogla janë ndër rrugët më të famshme dhe më të frekuencuara të Prishtinës. Si pije të preferuara në këto bare janë rakia tradicionale dhe birra. Përveç pijeve, në këto vende ofrohet edhe shërbimi i ushqimeve të ndryshme: të shpejt apo tradicional.



Lumenjt e Prishtinës **84** Prishtina deri në vitet e 70-80-ta i kishte edhe dy lumenj në qytet, që kaloheshin përmes urave. Me modernizimin e infrastrukturës ato janë mbuluar dhe sot përdoren si pjesë e sistemit të kanalizimit. Dy lumenjt Vellusha dhe Prishtevka mund të shihen ende në pikën ku bashkonin prapa stadiumit të qytetit.



Parku i Gërmisë **82** është parku kryesor i qytetit që ndodhet në verilindje të Prishtinës. Ka një sipërfaqe prej 1126 hektar dhe përdoret si hapësirë rekreative dhe turistike. Të dhëna tregojnë se rreth një milion njerëz e vizitojnë këtë park në vit. Është zonë e mbrojtur e natyrës që nga viti 1987.



Liçeni i Badovcit **85** është një nga dy liqenet afër Prishtinës që e furnizojnë edhe qytetin me ujë të pishëm. Badovcit është në afërsi të qytetit dhe është i lidhur me parkun e Gërmisë. Në afërsi të Badovcit është edhe parku i arinjeve, që është një park zoologjik i qytetit.



Që nga mesi i viteve 2000 kjo rrugë që mban emrin Nënë Tereze është e mblytur për makina dhe shërben vetëm për këmbësorët. Ajo është e shtruar me pllaka të granitit dhe gjithashtu ka rol

komercial dhe kulturor, ku shumica e aktivitetëve në qytet zhvillohen aty. Në dy skajet e rrugës ndodhen sheshi Skenderbeu dhe sheshi Zahir Pajaziti.

Sheshi Nënë Tereze

87 Është hapësira kryesore pedonale qytetit. Në vitet e 70 deri në vitet 2000 kjo hapësirë ka shërbyer si korzo e qytetit, ku banorët kanë dalur për shetjetë, kryesisht në mbremje. Por derisa gjatë ditës rruga ka qenë e hapur edhe për veturat dhe makinat tjera.

Katedralja

23 Kulla e këmbanës së Katedralës "Nënë Tereza" është një ndër ndërtesat më të larta në Prishtinë. Pozicionimi dhe lartësia e saj ofrojnë një pamje mahmëtesë të Prishtinës, nga të katër anët. Nga kjo pozitë, mund të shihen disa nga pjesët më interesante të qytetit, si kampusi i Universitetit të Prishtinës, pjesa perëndimore e qytetit nga ku përcillet perëndimi i diellit dhe në anët e tjera shihen ndërtesat e tjera të larta të qytetit. Që nga viti 2014, vizitorët mund të ngjiten në kullë dhe të shijojnë një pamje të rrallë të Prishtinës.

34

Kuvendi i Kosovës

19 E vendosur mbi Pazarin e vjetër të Prishtinës, u projektua fillimisht nga Bogdan Nestorović më 1948 dhe më vonë u adaptua dhe u riprojektua nga arkitekti i njohur kroat Juraj Neidhardt në vitin 1960. Ngjardhri i lindur në Zagreb, por që pjesën më të madhe të jetës e ka kaluar në Sarajevë; përfundoi shkollën e arkitekturës në Vjene dhe punoi në zyrën e Le Corbusier në Paris gjatë viteve 1932 dhe 1936. Gjatë viteve të fundit, ndërtesa u modifikua shumë sidomos në sallën e mbledhjeve të parlamentit, fasadën lindore dhe atë jugore.

Ndërtesa e Qeverisë (Ish-Banka e Kosovës)

13 Kjo ndërtesë ishte e njohur më parë si Banka e Kosovës dhe është e dizajnuar nga arkitekti Milan Tomiq dhe Milan Pavloviq. U ndërtoi në vitet '80-të, dhe në atë kohë ishte ndërtesa më e lartë në qytet. Plani fillestar ishte që dy ndërtesa identike të ndërtoheshin krahas njëra tjetres, por kjo plan nuk u realizua kurrë. Ndërtesa është bombarduar gjatë luftës në Kosovë në vitin 99 dhe më vonë u renovua duke humbur elegancën dhe bukurinë e saj që kishte dikur.

Monumente dhe kulturë

1. Hotel Unioni
2. Muzeu i Kosovës
3. Kompleksi Emin Gjiku
4. Hamami i Madh
5. Shtëpia e Gurit
6. Shtëpia Domaniku
7. Kisha e shën Kollit
8. Sahatkulla
9. Xhamia Jashar Pashës
10. Xhamia e Madhe

Hotele

29. Hotel Grand
30. Hotel Sirius
31. Swiss Diamond

Kompleksi Kurri

23. Katedralja Nënë Tereze
24. Muzeu i Pavarësisë
25. Ibrahim Kodra Museum
26. Teatri Kombëtar
27. Lapidariumi
28. Monumenti i LDB

32. Hotel Nartel
33. Hotel Emerald
34. Prishtina International
35. Hotel Real
36. Hostel Han
37. Tuba
38. Prishtina Center Hostel
39. White Tree
40. Oda
41. Buffalo Backpackers
42. Mami's Hostel
43. Centre Hostel
44. Guest House Konaku
45. Hotel Garden
46. Hotel Prishtina
47. Hotel Begolli
48. Hotel Prima
49. Hotel Ora

Gastronomi dhe bare

50. Gagi Restaurant
51. Soma Book Station
52. Kafja e Vogelë
53. Mezzeria
54. Babaganoush
55. Osteria Basilico
56. Papirun
57. Pishat
58. Tirona
59. Ponte Vecchio
60. Napoli
61. Mexicana
62. Miqt Taverna
63. Tiffany
64. Thai Restaurant
65. Himalayan Ghorka
66. De Rada
67. Miqt PUB
68. Ditenat

Tjera

78. Galeria Kombëtare
79. Muz. i Shtëpive Shkolla
80. Bill i Klinton përmend.
81. Parku i Arinjeve
82. Parku Arkeol. Ulpiana
83. Newborn
84. Parku Gërmia
85. Liçeni i Badovcit
86. Bashkimi i lumenjve
87. Sheshi Nënë Tereze

69. Liburnia Restaurant
70. El Greco Restaurant
71. Piccadilly Burek
72. Prishtina Burek
73. Emini Burek
74. Sonder Bar
75. Sabota